



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:176346

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06153916

PKR.nr.70/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, Kryetari i trupit gjykues Alban Ajvazi, me anëtarët e trupit gjykues: Avni Sylja dhe Sulltane Hoti, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.A, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.719/2015 të datës 28.02.2017, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 24.07.2024, në prezencën e Prokurores së shtetit Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit A.A me mbrojtësin e tij av. Remzush Latifi sipas detyrës zyrtare, me datë 30.07.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.09.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

A.A (A.), nga i ati A. dhe e ëma M., e gjinisë B., i lindur më ..., në ..., me numër personal ... (certifikata e lindjes e lëshuar nga shteti i Serbisë), me vendbanim në ..., Komuna e Prishtinës, i gjendjes së dobët ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Serbisë, gjendet nën masën e paraburgimit në burgun e sigurisë së lartë në Dyz, i dyshuar për një vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

I

Me datë 09.09.2015, rreth orës 21:00, në Prishtinë, në oborrin e Shkollës fillore, "Meto Bajraktari", i pandehuri ne momentin kur i ka vërejt pjesëtarët e policisë, e ka hedhë në tokë revolen e tipit "Zastava", me nr. serik ... dhe një karikator me dy fishek, të cilën e ka mbajte në pronësi ne shkelje me ligjin e zbatueshëm për armët,-

Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Gjykata në mbështetje të neneve 7, 17, 21, 41, 43, 46, 73 dhe 74 si dhe neneve 276, 360 dhe 364, të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej **500 (pesëqind) Euro**, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afatë prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par.3, të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për paushallin gjyqësor shumën prej pesëdhjetë (100) €, në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

URDHËR - URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i armës – revoles të tipit "Zastava", me nr. serik ... dhe një karikator me dy fishek si dhe i katër qeseve të substancës narkotike. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të njëjtat duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Konform nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së:

LIROHET NGA AKUZA

II

I pandehuri A.A, për shkak se në bashkëkryerje me të miturin L.L, në ditën kohën dhe vendin si në dispozitivin I të aktakuzës, i kanë hedhë në tokë katër qese të substancave narkotike, të cilat i kanë poseduar pa autorizim me qëllim të shitjes apo shpërndarjes së tyre,-

Me këtë kishte për të kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ushtruar aktakuzën PP/L.nr.719/2015 të datës 28.02.2017, ndaj të akuzuarit A.A, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së,

veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, me datë 29.09.2021, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, në të cilin i akuzuari është deklaruar i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Ku në prani të këtyre rrethanave është udhëzuar që brenda afatit prej 30 ditësh mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtim të provave. Mirëpo i njëjti brenda këtij afati nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë.

Tutje gjykata ka tentuar të mbaj shqyrtimin gjyqësor për të njëjtin, mirëpo i pandehuri nuk i'u është përgjigjur ftesave të gjykatës dhe për të është lëshuar urdhëresë për sjellje me shoqërim, urdhërarrest dhe letër-rreshtim vendor. Ku policia e Kosovës me datën 25.06.2024 e ka njoftuar gjykatën përmes email-it zyrtar se i pandehuri A.A gjendet në burgun e sigurisë së lartë në Dyz për një veprë tjetër penale.

Në prani të këtyre rrethanave, Gjykata ka vazhduar me rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, ku është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor me datën 24.07.2024, në të cilat është dhënë fjala hyrëse e palëve, gjithashtu për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, është bërë administrimi i provave materiale, është dhënë mbrojtja e të akuzuarit si dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i Shtetit Bukurije Gjonbalaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: aktakuza e ushtruar kundër të akuzuarit është e mbështetur në provat materiale të cilat e vërtetojnë gjendjen faktike, kështu që gjatë administrimit të këtyre provave do të vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, ashtu siç janë: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 09.09.2015, me të cilën vërtetohet se nga i pandehuri është konfiskuar arma e përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës, dhe substanca narkotike, të cilin vërtetim e ka nënshkruar vetë i pandehuri dhe fotot dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës, ku shihen katër qese të substancës narkotike dhe arma me dy fishek, gjithashtu shihet edhe vendi ku është gjetur në tokë, pasi që arma siç ka thënë i pandehuri gjatë ikjes nga policia i ka rënë në toke, si dhe narkotikun e ka hedh në tokë pasi që i pandehuri e ka pa policinë. Mbrojtën e të akuzuarit gjykata duhet të merr si të pa bazuar që është bërë për të i ikur ndjekës penale, deklarata e dhënë në polici është kontradiktore me deklaratën e sodit, pasi që i pandehuri thotë se policia më kanë rrah tre orë, kjo deklaratë duhet të merret e pa bazuar sepse i akuzuari është liruar në procedurë të rregullt dhe ka pas të drejt me kërkuar ndihmë mjekësore që do të vërtetohej kjo që deklaroj sot se i njëjti ka qenë i rrahur nga policia. Ndërsa i propozoj gjykatës që të njëjtit ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit, duke i pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e matjes së dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.A, av. Remzush Latifi, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: gjatë shqyrtimit të sotëm gjyqësor prokuroria nuk ka arritë me asnjë provë të vetme të vërtetoj se i mbrojturi im ka kryer veprat penale që i vihen në barrë, për me tepër i mbrojturi im deklaroj se është konsumues i rregullt i substancës narkotike, prandaj vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së fare nuk ekziston, pasi që i njëjti edhe nga zyrtaret policor është nxënë duke konsumuar substancën narkotike sëbashku me personat që u ceken më

lantë edhe arma e gjetur në tokë disa metra larg nga vendi ku kanë qenë duke konsumuar substancën nuk dihet se e kujt ka qenë, kush e ka gjuajtur nga personat të cilët kanë qenë me A., gjithashtu prokuroria nuk ka ariut të ofrojë prova të mjaftueshme që do të vërtetonin se i mbrojturi im i ka kryer veprat penale, për të cilat akuzohet. I propozoj gjykatës që të mbrojturin tim ta lirojë nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari A.A në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe dua të shtojë se asnjëherë në jetën time nuk kam shitë narkotik, s'kam qenë as i dënuar, as i dyshuar për kesi vepra penale.

Procedura e Provave:

Në shqyrtimin gjyqësor publik gjykata konform nenit 7 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjithashtu gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me këtë çështje penale juridike, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 360 të KPPRK-së, ka administruar provat materiale si në vijim: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 09.09.2015 dhe fotot dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 09.09.2015, vërtetohet se nga i akuzuari është konfiskuar revolja e tipit "Zastava", me numër serik ... dhe një karikator me dy fishek si dhe katër qese të vogla të substancës narkotike, sasia e të cilave nuk dihet pasi që nuk është matë në mungesë të peshores nga zyrtarët policor, të cilin vërtetim e ka nënshkruar vetë i pandehuri.

Nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës, shihet revolja e tipit "Zastava", me një karikator me dy fishek si dhe katër qese të vogla të substancës narkotike, të cilat janë gjetur në vendin e ngjarjes në tokë.

Pas deklarimit të dëshmitarëve dhe administrimit të provave materiale, i akuzuari ka paraqitur mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.07.2024, i akuzuari A.A ka deklaruar se: ditën kritike kam qenë në oborrin e shkollës "Meto Bajraktari" sëbashku me 5-6 persona tjerë duke pirë cigare të llojit marihuanë, në momentin kur ka ardhë policia asnjëri prej nesh nuk ka tentuar të ikë dhe në oborr policia kishte gjetur një armë dhe substancë narkotike, të cilat nuk kanë qenë të mijat dhe nuk e di të kujt kanë qenë, por në momentin kur na ka arrestuar policia, na kishte dërguar në stacion policor, unë fillim nuk i kam pranuar veprat penale që jam dyshuar se i kam kryer, por pasi që policia më kanë maltretuar duke na rrahur fizikisht jam detyruar me pranuar që arma dhe substanca narkotike ka qenë e imja dhe se unë i kam kryer veprat penale për të cilat akuzohem.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata duke vlerësuar gjitha provat një nga një dhe gjitha së bashku, në përputhje me nenin 360 të KPPRK-së, për të akuzuarin lidhur me veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPPRK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Faktet jo kontestuese:

Nga të gjitha këto prova të administruara, për gjykatën dhe palët nuk ishte kontestuese se në oborrin e shkollës "Meto Bajraktari" në ditën kritike kur është arrestuar i akuzuari, nga policia janë gjetur revolja e tipit "Zastava", me numër serik ... dhe një karikator me dy fishek si dhe katër qese të vogla të substancës narkotike, po ashtu nuk është kontestuese se i akuzuari sëbashku me shokët e tij, kur kanë arritur policia kanë qenë duke konsumuar cigare të llojit marihuanë.

Faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes të palëve. Përveç kësaj, faktet e tilla vërtetohen nga dëshmia e të akuzuarit dhe nga provat materiale të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor.

Faktet kontestuese:

Kontestuese dhe e pavërtetuar deri në fund të shqyrtimit gjyqësor, mbeti rrethana se i akuzuari a e kishte pasur në posedim revolen e tipit "Zastava", me një karikator me dy fishek si dhe katër qese të vogla të substancës narkotike, në ditën kritike për të cilët e akuzohet.

Faktet kontestuese gjykata i ka zgjidhur pas administrimit të provave materiale gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dhe analizimit të deklaratës së të akuzuarit gjatë mbrojtjes së tij.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar secilën provë veç e veç, e posaçërisht vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve të datës 09.09.2015, ku vërtetohet se nga i akuzuari është konfiskuar revolja e tipit "Zastava", me numër serik ... dhe një karikator me dy fishek si dhe katër qese të vogla të substancës narkotike, sasia e të cilave nuk dihet pasi që nuk është matë në mungesë të peshores nga zyrtarët policor, të cilin vërtetim për konfiskim e ka nënshkruar vetë i akuzuari. Po ashtu nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës, shihet revolja e tipit "Zastava", me një karikator me dy fishek si dhe katër qese të vogla të substancës narkotike, të cilat janë gjetur në vendin e ngjarjes në tokë në momentin kur e ka arrestuar policia të akuzuarin. Ashtu që gjykata pas vlerësimit me ndërgjegje të provave të lartcekura gjeti se të njëjtat janë kredibile dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, si të tilla, gjykata të njëjtave i'a ka fal besimin, pasi që ishin të besueshme dhe me fuqi provuese dhe vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të gjitha këto rrethanë për gjykatën rezulton se provat që mbështesin aktakuzën krijohet dyshimin i bazuar mirë që janë përmbushur elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i njëjti.

Dashja

Gjykata vërtetoje faktin se te i akuzuari ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sepse veprimi i tij është i kundërligjshëm, për këtë ishte i vetëdijshëm dhe e ka dëshiruar kryerjen e kësaj vepre penale, pasi që i njëjti me vetëdije e kishte mbajtur në posedim revolen e tipit Zastava.

Në dispozitën ligjore nga neni 374 par.1 të KPRK-së, përkatësisht në veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, thuhet se *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”*.

Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore dhe ekzistojnë elementet objektive dhe subjektive të akuzuarit se ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, me ç'rast i akuzuari e ka mbajtur në posedim armën e tipit Zastava e cila në momentin e arrestimit të tij nga policia është gjetur tek i njëjti sëbashku me një karikator me dy fishek.

Kështu që duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjykata e ka shpallur fajtor të akuzuarin, për shkak të veprës penale të lartcekur, ngase me veprimet e të njëjtit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, për çka gjeti se e njëjta është pjesërisht e bazuar në provat materiale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultojë se me të drejtë u provua se i akuzuari ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e mbrojtjes së të akuzuarit dhe fjalën e tyre përfundimtare, për çka gjeti e njëjta është pjesërisht e bazuar vetëm në raport me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti është i moshës së re, ndërsa si rrethanë rënduese ndaj të akuzuarit gjeti mënyrën si i ka kryer veprën penale që i vihet në barrë dhe se i njëjti është i dyshuar edhe për vepër tjetër penale, pasi që gjendet në paraburgim për një rast tjetër. Andaj gjykata duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura, i shqiptoj dënim dhe sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit komfor nenit 38 të KPRK-së.

Lidhur me vendimin si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi:

Sipas vlerësimeve të gjykatës, veprimet te akuzuarit ne raport me këtë vepër penale nuk qëndrojnë, pasi ne asnjë rrethane nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari të ketë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e ky fakt vërtetohet edhe nga deklaratat e të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili ka deklaruar

se substancën narkotike e ka pas në posedim vetëm për konsumim personal dhe për shokët e tij të cilët kishin qenë duke pirë sëbashku në ditën kritike kur ishin arrestuar nga policia, e ky deklaram i të akuzuarit gjen mbështetje edhe në provat materiale vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të datës 09.09.2015, ku vërtetohet se nga i akuzuari janë konfiskuar katër qese të vogla të substancës narkotike, sasia e të cilave nuk dihet pasi që nuk është matë në mungesë të peshores nga zyrtarët policor, të cilin vërtetim e ka nënshkruar vetë i pandehuri, po ashtu kjo sasi e vogël e narkotikut shihet edhe nga prova materiale foto dokumentacioni që gjendet në shkresa të lëndës, ku shihet se sasisë e narkotikut në foto është e vogël, pasi që e njëjta po të kishte qenë për shitje do të ishte në sasi më të madhe.

Pasi që deklarimi i të akuzuarit gjen mbështetje edhe në provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata të njëjtës i'a fali besimin, pasi që e njëjta ishte e besueshme, kredibile dhe në lidhshmëri me provat materiale të lartcekura.

Gjykata në rastin konkret pati parasysh edhe dispozitën ligjore nga neni 359 par.2 të KPPRK-së, që në rastin konkret të bëjë rikualifikimin e veprës penale nga Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, mirëpo për këtë të fundit kishte arritur parashkrimi absolut, andaj mbi këtë arsye nuk bëri rikualifikim të kësaj vepre penale.

Konfiskimi i sendeve:

Gjykata në mbështetje të nenit 374 par.3 dhe 273 par.5 të KPRK-së si dhe nenit 276 par.1 dhe par.2, pika 2.1 dhe 2.4 të KPPRK-së, ndaj të akuzuarit ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të armës – revoles të tipit "Zastava", me nr. serik ... dhe një karikator me dy fishek si dhe të katër qeseve të substancës narkotike të cekura si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës:

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par.3, pika.3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të arsyeve të dhëna si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.70/2017, datë 12.09.2024**

G j y q t a r i

Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.